




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KUJTESA NET
Fiton PEJA
Pronar
Prishtinë

Rasti Nr. 2019/68
Ref:1910/1275/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën Nr. 2019/68 – ARTMOTION (“Pala Ankuese”) kundër KUJTESA NET (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 4 korrik 2019 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Pala Ankuese ndaj Palës Përgjegjëse. Pala Ankuese pretendon se Pala Përgjegjëse është duke i ritransmetuar disa kanale turke si: A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL pa të drejta të ritransmetimit, kanale për të cilat Pala Ankuese posedon të drejtat ekskluzive të transmetimit për Territorin e Republikës së Kosovës.
3. KPM nëpërmes një shkrese me datën 16 gusht 2019, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda afatit dhjetë ditësh të ofrojë dëshmi shtesë për të drejtën e ritransmetimit të kanaleve turke të sipërpërmendura.
4. KPM me datën 2 shtator 2019, ka pranuar përgjigje nga ana e Palës Përgjegjëse lidhur me shkresën duke pretenduar se për të drejtën e ritransmetimit të kanaleve turke ka deponuar marrveshjen që ka me operatorin D.P.SH. EAGLE përmes të cilës ka siguruar të drejtat e transmetimit.
5. KPM nëpërmes një shkrese me datën 12 shtator 2019, me qëllim të sqarimit të kësaj çështje, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që në afat prej 10 ditësh të deponoj në KPM autorizimet/konfirmimet nga ana e kanaleve A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZIK, TRT BELGESEL, të cilat do të dëshmonin se

dhënësi i të drejtave TUYAD/Uydu Elektronik Iletisim Isinsanlari Dernegi e ka të drejtën e rishitjes së tyre në territorin e Kosovës përmes operatorit D.P.SH EAGLE.

6. KPM me datën 23 shtator 2019, ka pranuar pergjigje nga ana e Palës Përgjegjëse ku thuhet së brenda një periudhe të shkurt kohore, përmes operatorit D.P.SH. EAGLE do ti sigurojnë autorizimet/konfirmimet të cilat dëshmon se dhënësi i të drejtave TUYAD/Uydu Elektronik Iletisim Isinsanlari Dernegi e ka të drejtën e rishitjes në territorin e Kosovës përmes operatorit të shpërndarjes D.P.SH. EAGLE.
7. KPM me datën 4 tetor 2019, i ka dërguar një Njoftim Palës Përgjegjëse përmes të cilës e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01 duke i larguar kanalet turke A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL nga transmetimi menjëherë pas pranimit të kësaj letre, në të kundërtën Komisionit i KPM-së do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
8. KPM me datë 7 tetor 2019, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse në të cilën thuhet se është e interesuar që kjo qështje të zgjidhet dhe kërkon nga KPM që t'i drejtohet operatorit të shpërndarjes D.P.SH.EAGLE që të marrin informata të kërkuesve dhe do e dëshmojnë që e kanë të drejtën e rishitjes së kanaleve turke të cekura më lartë për territorin e Kosovës.

Analiza Ligjore

9. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e kartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim të nenit 4, paragrafi 1, dhe nenit 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.”

10. KPM ka gjetur se edhe përkundër kërkesave të KPM-së për respektim të të drejtës së transmetimit Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke i transmetuar kanalet turke pa marrëveshje valide.
11. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të sigurojë dëshmi shtesë përmes të cilave do të dëshmonte se ka siguruar të drejtat e transmetimit të kanaleve A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL. Pala Përgjegjëse ka deponuar një marrëveshje me operatorin D.P.SH EAGLE, mirëpo ka dështuar të sigurojë dëshmi shtesë autorizime/konfirmime nga kanalet turke se dhënësi i të drejtave TUYAD/Uydu Elektronik Iletisim Isinsanlari Dernegi e ka të drejtën e rishitjes në territorin e Kosovës përmes operatorit të shpërndarjes D.P.SH. EAGLE.

